



Strategjia

Kontrolli i Sigurimit të cilësisë

Në kuadër të realizimit të mbikëqyrjes lidhur me kontrollin e cilësisë strategjia e BMP është kryerja e inspektimeve të sigurimit të cilësisë duke i dhënë prioritet zbatimit të kërkesave ligjore që lidhen me periudhën e kontrollit dhe vlerësimit me faktorë të lartë risku të subjekteve të identifikuara nga procesi i investigimit.

Gjithashtu do të vijohet me realizimin e kontrollit të cilësisë për audituesit që kanë audituar njësi ekonomike jo me interes publik, të cilët nuk kanë qenë subjekt i kontrollit të cilësisë në 6 vitet e fundit, si dhe kontrolli i cilësisë për audituesit e rinj që kanë më pak se 5 vite angazhim në ushtrimin e profesionit.

Për të mundësuar këto kontrolle të cilësisë, përveç planifikimit për të shtuar kapacitetet me inspektor të brendshëm të kontrollit të cilësisë BMP do të mbështetet edhe në angazhimin e ekspertëve të jashtëm jo praktikues, për të mundësuar realizimin e kontrollit të cilësisë së këtyre subjekteve.

Inspektimet tematike për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Në kuadër të realizimit të mbikëqyrjes me qasje në rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në zbatim të metodologjisë së mbikëqyrjes të bazuar në rrezikun e parandalimit dhe pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në rregulloren nr. 12, datë 02.07.2020 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, udhëzuesin për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit dhe manualit për mbikëqyrjen e subjekteve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje, BMP do të vijojë me realizimin e inspektimeve në vend dhe në distancë të subjekteve të mbikëqyrura prej tij, raportimi dhe marrja e masave disiplinore dhe administrative, në rast se do të konstatohen mangësi në programet dhe zbatimin e masave të PPP/FT nga subjektet e mbikëqyrura.

Mbikëqyrja e Kontabilistëve të Miratuar dhe organizatave profesionale përkatëse

Në kuadër të rregullimit dhe mbikëqyrjes së profesionit të Kontabilistëve të Miratuar të parashikuar në rregulloren nr. 9, proceset dhe aktivitetet e planifikuara do të jenë në nivel



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

mbikëqyrje dhe koordinim të ushtrimit të profesionit të kontabilistit të miratuar, verifikimit të KM-ve dhe çështjeve të edukimit të vijueshëm profesional.

Trajnime të ndryshme për zhvillimin e stafit

BMP do të vijojë trajnimin e stafit përmes pjesëmarrjes në seminare apo trajnime të ndryshme me qëllim rritjen e mëtejshme të aftësive të tyre profesionale në kuadër të veprimtarisë mbikëqyrëse. Kjo veprimtari do të realizohet lidhur me çështje të raportimit financiar, kontrollit të cilësisë dhe çështje të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Bashkëpunime me institucione të tjera

BMP, me qëllim realizimin e misionit dhe vizionit të tij mbikëqyrës, do të vijojë bashkëpunimin e tij aktiv me institucione të tjera qendrore e lokale në vend si Prokuroria e Përgjithshme, Agjensia e Inteligjencës Financiare, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Bashkëpunime të tjera do të synohen të vijojnë gjithashtu edhe me shoqatat e biznesit dhe institucionet e drejtësisë.